

"EGNATIA GROUP" SHA
RRUGA "PANORAMA", KULLA E BIZNESIT, TIRANË
NIPT K33315201I

VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Sot më datë 20.08.2019, ora 10:00, në adresën e selisë të Shoqërisë "Egnatia Group" sh.a, të ndodhur në Rruga "Panorama", Kulla e Biznesit, Njësia Bashkiake Nr. 9, Tiranë, Shqipëri, realizohet Mbledhja e Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë "Egnatia Group" sh.a., një shoqëri e regjistruar me NUIS K33315201I (më poshtë referuar si "Shoqëria").

Në mbledhje është i pranishëm aksionari:

1. Z. Irfan Hysenbelliu, zotërues i 100% të aksioneve të Shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme është mbledhur në respektim të dispozitave përkatëse të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar). Duke qenë se janë të pranishëm aksionarë që përfaqësojnë shumicë të mjaftueshme të kapitalit të shoqërisë për mbajtjen e kësaj mbledhje, do të konsiderohet se mbledhja do të vendosë në mënyrë të vlefshme mbi çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

1. **Dhënien e miratimit për heqjen dorë nga kthimi i huave në vlerën 800,000,000 (tetëqind milion) lekë të dhëna nga aksionari Irfan Hysenbelliu në favor të shoqërisë 'Egnatia Group' sh.a, me qëllimin e vetëm që kjo shumë të kalohet si kontribut në zmadhimin e kapitalit të shoqërisë.**
2. **Dhënien e miratimit për emërimin e Ekspertit Kontabël të miratuar për të kryer raportin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë;**
3. **Të ndryshme.**

Aksionari prezent në mbledhjen e asamblesë, bazuar në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqërisë si dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(i ndryshuar).

Për sa më sipër:



"EGNATIA GROUP" SHA
RRUGA "PANORAMA", KULLA E BIZNESIT, TIRANË
NIPT K33315201I

ASAMBLEJA E SHOQËRISË

VENDOSI:



1. Të japë miratimin për heqjen dorë nga kthimi i huave të dhëna nga aksionari Irfan Hysenbelliu në vlerën 800,000,000 (tetëqind milion) lekë në favor të 'Egnatia Group' sh.a, si dhe kalimin e kësaj shumë si kontributi për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë 'Egnatia Group' sh.a;
2. Të japë miratimin për emërimin në detyrën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar për të kryer raportin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë z. Agim Qenani, lindur në Korçë dhe banues në Elbasan, pajisur me Nr. Liçence profesionale 53, nga Instituti i Ekspertëve të Autorizuar;
3. Të autorizojë administratorin e shoqërisë, z. Klodi Ajazaj, të depozitojë personalisht apo nëpërmjet një personi të autorizuar këtë vendim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (Q.K.B) për efekt të regjistrimit të tij.

Duke mos pasur asnjë gjë tjetër për të diskutuar, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë deklarohet e mbyllur në orën 11:00.

Konform rregullave statutore dhe ligjore ky vendim do të regjistrohet menjëherë në Q.K.B.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Z. IRFAN HYSENBELLIU



"EGNATIA GROUP" SHA
RRUGA "PANORAMA", KULLA E BIZNESIT, TIRANË
NIPT K33315201I

VENDIM
I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

Sot më datë 30.08.2019, ora 10:00, në adresën e selisë të Shoqërisë "Egnatia Group" sh.a, të ndodhur në Rruga "Panorama", Kulla e Biznesit, Njësia Bashkiake Nr. 9, Tiranë, Shqipëri, realizohet Mbledhja e Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë "Egnatia Group" sh.a., një shoqëri e regjistruar me NUIS K33315201I (më poshtë referuar si "Shoqëria").

Në mbledhje është i pranishëm aksionari:

1. Z. Irfan Hysenbelliu, zotërues i 100% të aksioneve të Shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme është mbledhur në respektim të dispozitave përkatëse të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar). Duke qenë se janë të pranishëm aksionarë që përfaqësojnë shumicë të mjaftueshme të kapitalit të shoqërisë për mbajtjen e kësaj mbledhje, do të konsiderohet se mbledhja do të vendosë në mënyrë të vlefshme mbi çështjet e rendit të ditës si më poshtë:

1. **Dhënien e miratimit paraprak të raportit të veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë "Egnatia Group" sh.a.;**
2. **Dhënien e miratimit për zmadhimin e kapitalit të shoqërisë me kontribut nga aksioneri i vetëm.**
3. **Të ndryshme**

Aksionari prezent në mbledhjen e asamblesë, bazuar në dispozitat përkatëse të Statutit të Shoqërisë si dhe Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(i ndryshuar).

Për sa më sipër:

ASAMBLEJA E SHOQËRISË
VENDOSI:



"EGNATIA GROUP" SHA
RRUGA "PANORAMA", KULLA E BIZNESIT, TIRANË
NIPT K33315201I

1. Të japë miratimin për raportin e veçantë të ekspertit kontabël të autorizuar *z. Agim Qenani, lindur në Korçë dhe banues në Elbasan, pajisur me Nr. Liçence profesionale 53, nga Instituti i Ekspertëve të Autorizuar;*
2. Zmadhimin e Kapitalit të Shoqërisë 'Egnatia Group' sh.a me vlerën *800,000,000 (tetëqind milion) lekë, nëpërmjet kontributit të vetëm të aksionarit Irfan Hysenbelliu.*
3. Të autorizojë administratorin e shoqërisë, *z. Klodi Ajazaj, të depozitojë personalisht apo nëpërmjet një personi të autorizuar këtë vendim pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (Q.K.B) për efekt të regjistrimit të tij.*

Duke mos pasur asnjë gjë tjetër për të diskutuar, mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë deklarohet e mbyllur në orën 11:00.

Konform rregullave statutore dhe ligjore ky vendim do të rregjistrohet menjëherë në Q.K.B.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Z. IRFAN HYSENBELLIU

